



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 26.08.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe nenit 102.1 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28, duke e vërejtur se Komisioni për intervistimin e kandidatëve për vendin e punës: Zyrtar për arsim të mesëm të latë dhe konvikt, i formuar sipas vendimit 01 nr. 112-38376/2015, i ndryshuar me vendimin 01. nr 112-40373/2015, nuk është funksional për shkak të shfrytëzimit të pushimeve vjetore të anëtarëve të Komisionit, e miraton këtë:

V E N D I M

1. Revokohet në tërësi vendimi i Kryetares së Komunës së Gjakovës 01 nr. 112-38376 i dt: 05.06.2015 , për formimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për plotësimin e vendit të punës: Zyrtar për arsim të mesëm të lartë dhe për konvikt, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Kryetares së Komunës 01 nr. 112-40373 i dt: 16.05.2015 .
2. Revokimi i këtyre vendimeve bëhet për shkak të pengesave të punës së këtij Komisioni, të cilat janë të ndërlidhura me kuorumin për punë, për shkak se disa anëtarë të këtij Komisioni janë duke i shfrytëzuar pushimet vjetore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Anëtareve të Komisionit
 - Drejtorisë për Arsim
 - Zyrës së personelit
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila